

Kthimi vullnetar i asistuar dhe riintegrimi nga Belgjika

IOM mbështet migrantët që dëshirojnë të kthehen vullnetarisht në vendin e tyre të origjinës ose të migrojnë në një vend të tretë ku garantohet qëndrimi i përhershëm.

ÇKA ËSHTË KTHIMI VULLNETAR?

A MUNDET IOM TË MË NDIHMOJË?

SI FUNKSIONION?

KU MUND TË APLIKOJ?

ÇFARË MBËSHTETJE DO TË MARR?

ÇKA ËSHTË KTHIMI VULLNETAR?

Kthimi vullnetar është një shërbim falas për njerëzit që mendojnë të kthehen në vendin e origjinës nga Belgjika. Nëse vendosni që kjo është zgjidhja e duhur për ju, IOM, me mbështetjen e FEDASIL, dhe partnerët e saj do të kujdesen për gjithçka, duke përfshirë rezervimin e fluturimeve tuaja dhe t'ju udhëzojë për të siguruar që ju keni të gjitha dokumentet e nevojshme.

IOM MUND TË JU NDIHMOJË

Ndihma për kthim vullnetar e IOM është në dispozicion për të gjithë migrantët që ndodhen në Belgjikë, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor.

Mund të flisni me ne për kthimin vullnetar pa ndonjë detyrim. Gjithçka që diskutojmë do të mbahet konfidenciale. Ne do t'ju informojmë për ndihmën në dispozicion para, gjatë dhe pas nisjes tuaj.

Ju mund të diskutoni çdo shqetësim që mund të keni në lidhje me kthimin tuaj të mundshëm në një bisedë personale me një nga këshilltarët tanë. Për t'iu përgjigjur pyetjeve më specifike, ne mund të kontaktojmë kolegët tanë në zyrën e IOM në vendin tuaj të origjinës.

Nëse vendosni që kthimi vullnetar është zgjidhja e duhur për ju, IOM mund t'ju ndihmojë në të gjitha përgatitjet për udhëtimin tuaj.

SI FUNKSIONION?

Pasi të aplikoni për kthim vullnetar, IOM do t'ju kontaktojë për një këshillim gjatë të cilit do të shpjegohen të gjitha detajet. IOM mund t'ju ndihmojë duke ju udhëzuar për të marrë dokumentet tuaja të udhëtimit dhe do t'ju shpjegojë hapat e nevojshëm për të ndërmarrë. Pasi të jeni gati për të udhëtuar, IOM do të rezervojë udhëtimin tuaj. IOM do t'ju ndihmojë para nisjes në aeroport në Bruksel, por ju do të udhëtoni si një pasagjer i rregullt. Nëse është e nevojshme, IOM mund të sigurojë ndihmë në aeroportet gjatë tranzitit dhe pas mbërritjes.

KU MUND TË APLIKOJ?

Nëse banoni në një strukturë pritjeje, ju mund të aplikoni përmes qendrës duke i kërkuar asistentit tuaj social më shumë informacion rreth kthimit vullnetar.

Nëse banoni jashtë strukturës së pritjes ose në një adresë private, mund të kontaktoni një nga partnerët tanë të OJQ-ve (klikoni këtu për listën e plotë) për më shumë informacion ose një nga zyrat e kthimit të Fedasil. Ju lutemi gjeni këtu detajet e kontaktit për një nga partnerët afër vendbanimit tuaj.

Për të gjitha pyetjet në lidhje me kthimin dhe riintegrimin, mund të kontaktoni:

FR / ENG: 0491 / 56.05.23

NL / ENG: 0499 / 64.80.94

ÇFARË MBËSHTETJE DO TË MARR?

IOM do të rezervojë dhe paguajë biletën tuaj të aeroplanit dhe / ose autobusit për udhëtimin e kthimit dhe do t'ju sigurojë para xhepi për udhëtimin, të cilat do ti merrni në aeroport.

Në varësi të vendit ku ktheheni, ju mund të keni të drejtë në mbështetje për riintegrim. Kjo mbështetje ka për qëllim të jetë një mbështetje fillestare për ju që të riintegroheshi në shtëpi. Para nisjes, të gjithë aplikantët do të pajisen me informacion mbi mbështetjen e dedikuar për ata dhe do të marrin informacione kontakti për zyrën lokale të IOM.